

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Shërbim enkriptim mbi sistemet informatike të Albcontrol dhe monitorimi ndaj sulmeve kibernetike si dhe monitorimi i ambjenteve të sallave operacionale”
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (cpv):** 45233292-2 – instalim i pajisjeve të sigurisë; 72212730-5 – Shërbimet e zhvillimit të softwareve të sigurisë; 72254100-1 Shërbimet e testimit të softwareve; 73431000-2 Testimi dhe vlerësimi i pajisjeve të sigurisë
- **Vlera e fondit limit:** 46 666 666 (dyzetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh ose 444 995 (katërqind e dyzetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë) Euro pa tvsh. (Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës të Shqipërisë në datën 27.07.2023 është 104.87 Lek/ Euro).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ALBCONTROL SHA ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 18 666 666 leke pa tvsh (40% e fondit limit) dhe

2.2.2 Bilancet e viteve 2020, 2021 dhe 2022. miratuar nga organet perkatëse shtetërore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, dhe

2.2.3 Vërtetim të lëshuar nga Bashkia ose njësitë administrative për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 pranë të gjitha njësiteve vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit në QKB.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të ketë realizuar shërbime të ngjashme, një vlerë jo më të vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, natyra e shërbimeve të realizuara dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat e shërbimeve të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose e perditesuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO BS PAS 99:2012** Për sistemin e menaxhimit të Integruar ose e përditësuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

- **ISO 27001-2013 ose ISO 27001-2022**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose e perditësuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 22301: 2019** mbi Krijimin dhe mirembajtjen e vazhdueshme të sistemeve të menaxhimit ose e perditësuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë
- **ISO 20000-1:2018**, Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve ose e perditësuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

Argumentim: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjencisë Europiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit Europian EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative. Albcontrol është gjithashtu i certifikuar, për shkak të natyrës së aktivitetit me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2018, SES (Reg 2017/373).

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.3. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës Operatori ekonomik duhet të ketë në listepagese minimumi 4 (katër) punonjës të diplomuar në një nga degët (Informatike/Teknologji-Informacioni/Elektronike) të kualifikuar me implementimin, evidentimin dhe mbështetjen e implementimit të projektit duke pasur njohuri të kombinuara sipas kërkesave të mëposhtme;

Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve (PMP / PRINCE 2) ose të ngjashëm për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin certifikatat për secilin specialist të kërkuar.

Argumentim: Kjo kërkesë garanton që Operatori Ekonomik do të angazhojë specialiste të certifikuar për menaxhimin e projektit dhe se çdo problem që do dalë

gjate periudhes se suportit do te ndiqet sipas metodikes nderkombetare te menaxhimit te projekteve

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar per "ITIL Foundation" ose te ngjashem. Per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri Operoret Ekonomike duhet te paraqesin certifikatat per secilin specialist te kerkuar

Argumentim: *Duhet te sigurohet mbarevajtja e kontrates nga aspekti i manaxhimit te ofrimit me cilesi te sherbimeve dhe bazuar ne metodologji boterore. Prandaj OE duhet te vere ne dispozicion te kontrates një punonjes te certifikuar ITIL per te siguruar mbarevajtjen e saj gjate vitit.*

- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar ne fushen e sigurise se sistemeve te informacionit. Per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri Operoret Ekonomike duhet te paraqesin certifikatat per secilin specialist te kerkuar.
- Të paktën 1 (nje) punonjës të certifikuar për databazat në nivelin expert. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat për secilin specialist të kërkuar.
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për platformen dhe pajisjet enkriptuese. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat për secilin specialist të kërkuar.
- Një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikim
- Për çdo punonjës të certifikuar të përfshirë në projekt, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:
 - a) Certifikatat dhe diplomat përkatëse;
 - b) Listëpagesat sipas formatit E-Sig 025, të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 muajt e fundit nga data e fillimit të kësaj procedure.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Shenim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës (Sipas pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar). Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se kontrates, te gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

Argumentim: *Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e neni 41 pika 4 dhe pika 6 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose”*

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

2.3.4 Operatori duhet të dorëzojë skemën teknike dhe specifikimet teknike të paisjeve si dhe certifikatat e kërkuara për paisjet, sipas kërkesave të specifikimeve teknike.

Argumentim: *Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 6 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.3.5 OE, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar, apo te tjere lejuar/certifikuar/autorizuar nga prodhuesi për platformën dhe paisjet enkriptuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, gjithashtu AK ka të drejtë për të vërtetuar dhe provuar saktësinë e të dhënave të Autorizimit të Prodhuesit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të LPP: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentat e tyre në gjuhën shqipe ose anglisht (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e Referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimin objekt procedure prokurimi, natyrën dhe afatin kohor për realizimin e këktij shërbimi si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41/1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Shënim: *Përcaktimi i specifikimeve teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikime Teknike

Shërbim enkriptim mbi sistemet informatike të Albcontrol dhe monitorimi ndaj sulmeve kibernetike si dhe monitorimi i ambjenteve të sallave operacionale

1 PËRMBAJTJA

SPECIFIKIMET TEKNIKE.....	Error! Bookmark not defined.
1 FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT.....	Error! Bookmark not defined.
1.1 Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit	Error! Bookmark not defined.
2 NËNSHKRIMET MIRATUESE.....	Error! Bookmark not defined.
3 PËRMBAJTJA.....	7
4 PËRFITUESI /AUTORITETI KONTRAKTUES.....	8
4.1 Hyrje.....	8
5 OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA.....	9
5.1 Objektivi i Përgjithshëm.....	9
5.2 Qëllimi.....	9
5.3 Rezultat që duhet të arrihen nga Operatori Ekonomik	10
6 LOGJISTIKA DHE KOHA	10
7 SUPOZIMET DHE RISQET	11
7.1 Supozimet e projektit.....	11
7.2 Risqet	11
8 GARANCIA	11
9 ZBATIMI I PROJEKTIT	11
9.1 Menaxhimi i projektit	11
10 PLANIFIKIMI I BUXHETIT.....	12
11 AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT	12
12 KËRKESAT TEKNIKO-FUNKSIONALE	13
13 PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT	25

2 PËRFITUESI /AUTORITETI KONTRAKTUES

Albcontrol është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, pronë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Albcontrol u krijua si ndërmarrje shtetërore në vitin 1992 dhe, në 3 shkurt 1999, u transformua në shoqëri aksionare, e quajtur Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror.

Albcontrol menaxhon dhe kontrollon hapësirën ajrore Shqiptare (FIR), në përputhje me standartet ndërkombëtare të lundrimit ajror.

Që prej vitit 2003, Albcontrol është anëtare e EUROCONTROL. Në vitin 2009 u anëtarësua në CANSO Global (Civil Air Navigation Services Organization) dhe, që prej janarit të vitit 2016, është anëtare me të drejta të plota e CANSO Europe Region.

Misioni i Albcontrol është të ofrojë shërbime të navigimit ajror, në pajtueshmëri me standartet ndërkombëtare në lidhje me sigurinë, cilësinë dhe kujdesin ndaj mjedisit, dhe të jenë të orientuar drejt klientit.

Albcontrol përdor burimet e tij njerëzore dhe mjetet operative, teknike dhe financiare për të përmbushur me sukses misionin e tij, për të reduktuar vonesat në operacione me qëllim rritjen e kapacitetit të trafikut ajror. Bashkëpunimi me vendet fqinje dhe partnerët në fushën e navigacionit ajror është i një rëndësie të madhe për të realizuar me sukses misionin tonë.

2.1 Hyrje

Një nga detyrimet kryesore të Albcontrol, si kompani e rëndësisë së veçantë dhe që ofron shërbime unike në tregun shqiptar të trafikut ajror, është garantimi i zbatimit të proceseve dhe rregullave të përditshme të punës, me qëllim ofrimin cilësor dhe të pandërprerë të shërbimeve. Këto rregulla shtrihen në të gjitha proceset e punës së institucionit dhe një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe aplikimit të tyre në infrastrukturën ICT të kompanisë.

Gjithashtu, Albcontrol ka për detyrë të garantojë sigurinë e rrjetit dhe komunikimeve të përdoruesve dhe shërbimeve të implementuara në to. Për këtë arsye, lind nevoja e përmirësimeve dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të infrastrukturës së rrjetit të komunikimit në të gjithë komponentet e saj, në mënyrë që kjo infrastrukturë të jetë gjatë

gjithë kohës funksionale dhe e përditësuar në versionet e fundit që adresojnë problematikat e njohura të shërbimit dhe sigurisë.

3 OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

3.1 Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i kësaj kontrate është mbarëvajtja e infrastrukturës së rrjetit, sigurisë dhe komunikimeve. Albcontrol ka identifikuar disa nevoja të cilat janë dhe objektivi i këtij projekti dhe janë radhitur si më poshtë.

- Siguri me shumë nivele - Përpunim dhe ruajtje e të dhënave konfidenciale me klasifikime të ndryshme sigurie në një produkt të vetëm duke garantuar konfidencialitetin në të gjitha nivelet kombëtare dhe përkatëse të klasifikimit të kufizuar ndërkombëtar.
- Arkitekturë sistemi modular - Pavarësisht vendodhjes, të mundesohet puna në mënyrë të sigurt dhe efektive. Te garantohet niveli më i lartë i sigurisë së të dhënave për pothuajse të gjitha kanalet e rëndësishme të komunikimit – nga VoIP, video-konferencat dhe lidhjet satelitore në WLAN dhe MTS.
- Mbrojtje e perdoruesve kundër kërcënimeve dhe rrezikut dixhital për mjedisin e punës me sistem të integruar të menaxhimit të rasteve për të vlerësuar atë që po ndikon në këte mjedis.

Secili prej objektivave të mësipërm ka një kontribut të veçantë në synimet e strategjisë së Albcontrol dhe ato përbëjnë edhe bazën e kërkesave të domosdoshme teknike dhe funksionale që duhet të plotësohen nga kontraktori.

3.2 Qëllimi

Nëpërmjet kësaj kontrate Albcontrol synon të adresojë zgjidhjen e pikave të mëposhtme:

- Shmangien e problemeve të sigurisë së rrjetit aktual dhe adresimin e zgjerimit të kërkesave në rritje të infrastrukturës së Albcontrol.
- Mbrojtja gjithëpërfshirëse e të dhënave të klasifikuara në nivele të ndryshme, si në nivel lokal ashtu edhe gjatë transferimit nëpërmjet rrjeteve të hapura.
- Sigurimi i të dhënave personale dhe parandalimi i çfarë do shkatërrimi të paqëllimshëm, ose të qëllimshëm të paautorizuar të tyre.

- Monitorim i vazhdueshëm i komunikimeve të kontrollorëve të Albcontrol.

3.3 Rezultat që duhet të arrihen nga Operatori Ekonomik

Shërbimet e ofruara duhet të përfshijnë:

- Optimizimi dhe adaptimi i sistemeve ekzistuese të sigurisë të rrjetit sipas kërkesave të përfituesit të projektit.
- Furnizimi dhe instalimi i paisjeve hardware me licensat, kartat e sigurisë dhe çelsat e sigurisë sipas specifikimeve teknike dhe kompatibël me sistemin e instaluar.
- Konfigurimi dhe lidhja në rrjetin ekzistues të diodave paisjeve enkriptuese sipas kërkesave të përfituesit të projektit.
- Furnizimin e suportit të prodhuesve përkatës së bashku me update/upgrade të zgjidhjes në versionet me të fundit të publikuara nga prodhuesit.
- Sigurimi i një platforme inteligjente për monitorimin dhe analizën e kërcenimeve kibernetike.
- Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i mikrofonave për monitorimin e vazhdueshëm të kontrollorëve dhe software-it përkatës të tyre.
- Dokumentimi i plotë i të gjithë instalimeve dhe konfigurimeve të realizuara.

4 LOGJISTIKA DHE KOHA

a. Vendndodhja

Shërbimet e sigurisë do të vendosen në bashkëpunim me stafin e Albcontrol sh.a dhe Operatorin Ekonomik gjatë fazës së analizës paraprake të nevojave dhe kërkesave për projektin.

b. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të shërbimit do të jetë data e firmosjes së kontratës. Nga kjo datë brenda një afati 9-mujor dhe të përmbushen të gjitha detyrimet kontraktuale për sa i përket implemetimit të pajisjeve dhe përmirësimit të sigurisë së rrjetit. Periudha e mirëmbajtjes për zgjidhjen që do të implementohet duhet të jetë 12 muaj.

5 SUPOZIMET DHE RISQET

5.1 Supozimet e projektit

Realizimi me sukses i rezultateve të sipërpërmendura, ka nevojë të mbështetet në supozimet e mëposhtme:

- Stafi i autoritetit kontraktor do të vërë në dispozicion të personelit të operatorit ekonomik të gjithë informacionin e nevojshëm, pjesë e objektit të këtij projekti;
- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti;
- Stafi i autoriteti kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë të gjejë konsensusin në rastet kur kërkohet;
- Stafi i autoriteti kontraktor dhe operatorit ekonomik duhet të jetë i aftë dhe original në zgjidhjen e problemeve.

5.2 Risqet

Është i rëndësishëm impenjimi i plotë i grupeve të punës pjesëmarrëse në zhvillimin e projektit.

Disa nga faktorët që do të mund të riskonin ecurinë e projektit:

- Mospërmbushja e plotë e kërkesave kohore nga operatori ekonomik;
- Vlerësimi jo i saktë i situatës aktuale të infrastrukturës ekzistuese;
- Mos përcaktimi i saktë i burimeve të nevojshëm për realizimin e projektit;
- Rrezik me humbjen e konfidencialitetit të informacioneve mbi konfigurimet;
- Dëmtim apo shpërndarje e pa autorizuar e e çelsave, kartave të sigurisë.

6 GARANCIA

Garancia e pajisjeve të lëvruara do të jetë 1 (një) vit.

7 ZBATIMI I PROJEKTIT

7.1 Menaxhimi i projektit

- Furnizuesi duhet të jetë përgjegjës për implementimin, adaptimin, testimin, shpërndarjen dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të projektit.
- Furnizuesi duhet të sigurojë një plan zbatimi të projektit me piketa të qarta.

8 PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Njësia	Çmimi
1	Pajisje rrjeti enkriptuese	4	Copë	
2	Server	1	Copë	
3	Workstation i enkriptuar (Laptop)	3	Copë	
4	Switch	1	Copë	
5	Mikrofonë	23	Copë	
6	Aplikacioni për menaxhimin e mikrofonëve	1	Copë	
7	Platforma inteligjente e sigurisë	1	Copë	
8	Mirëmbajtje	12	Muaj	
TOTALI ME TVSH (LEKË)				

9 AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9	M10 - M21
1	Vizita në site	X									
2	Lëvrimi i pajisjeve instalimi i tyre	X	X	X	X	X					
3	Faza e implementimit dhe konfigurimit						X	X	X	X	
4	Faza e testimit dhe marrja në dorëzim									X	
5	Mirëmbajtja										X

10 KËRKESAT TEKNIKO-FUNKSIONALE

Infrastruktura e rrjetit në Albcontrol është një infrastrukturë komplekse në të cilën janë ngritur shërbimet dhe komponentët e mëposhtëm:

- Sistemi i rrjetit (routing, switching dhe i sigurisë)
- Sistemi i telefonisë VOIP
- Sistemi wireless

Qëllimi kryesor i zbatimit të këtij projekti është ofrimi i shërbimeve të sigurisë së rrjetit dhe komunikimeve të Albcontrol. Për të realizuar infrastrukturën e sigurtë të rrjetit dhe të përdoruesve të tij, do të bëhet instalimi i pajisjeve të rrjetit enkriptuese dhe qendrës së menaxhimit të menaxhimit të sigurisë. Gjithashtu duhet të bëhet pajisja edhe me workstations të enkriptuar që mundësojnë transferimin, procesimin dhe ruajtjen e sigurtë të dokumenteve dhe informacioneve të klasifikuara.

Zgjidhja e ofruar nga Operatori Ekonomik duhet të sigurojë benefitet e mëposhtme për Albcontrol:

- Infrastrukturë që siguron mbrojtje kundër emetimeve dhe manipulimeve. Autentifikimi i sigurt duhet të kryhet me anë të teknologjisë së kartave inteligjente, që nuk lejojnë që të dhënat e ruajtura të lexohen nga palë të paautorizuara.
- Përpunim dhe ruajtje e të dhënave konfidenciale me klasifikime të ndryshme sigurie në një produkt të vetëm duke garantuar konfidencialitetin në të gjitha nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Pavarësisht vendodhjes, të mundësohet puna në mënyrë të sigurt dhe efektive duke u garantuar niveli më i lartë i sigurisë së të dhënave për pothuajse të gjitha kanalet e rëndësishme të komunikimit.
- Mbrojtje e përdoruesve kundër kërcënimeve dhe rrezikut digjital për mjedisin e punës me sistem të integruar të menaxhimit të rasteve për të vlerësuar atë që po ndikon në këtë mjedis.
- Sigurimi i të dhënave personale dhe parandalimi i çfarë do shkatërrimi të paqëllimshëm, ose të qëllimshëm të paautorizuar të tyre.

Operatori ekonomik duhet të mundësojë një arkitekturë sigurie për përpunimin, ruajtjen transferimin e mbrojtur dhe gjithashtu një gjurmë të plotë auditimi të informacionit të

klasifikuar dhe të dhënave të tjera të ndjeshme. Ideja thelbësore e kësaj arkitekture sigurie është mbrojtja gjithëpërfshirëse e të dhënave të klasifikuara në nivele të ndryshme, si në nivel lokal ashtu edhe gjatë transferimit nëpërmjet rrjeteve të hapura. Komponentët kryesore të kësaj arkitekture për sigurinë në komunikime duhet të përfshijnë:

- *Pajisje rrjeti enkriptuese dhe qender menaxhimi sigurie* që do të përdoren për krijimin, konfigurimin dhe administrimin e infrastrukturës së sigurtë të rrjetit dhe përdoruesve të tij;
